



Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Paneli për përzgjedhjen e Guvernatorit/es të Bankës Qendrore publikon:

Shpallje

Për plotësimin e pozitës së Guvernatorit/es të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar i kandidatit/es:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë përgatitje universitare në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështje juridike;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështje juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të ketë përvojë dhe aftësi menaxheriale;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- CV;
- Letër motivuese;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e ID-së;
- Kopjet e diplomave (të noterizuara), ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe

- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat e mundshme (opsionale).

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedhë një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e lartcekur përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org

Emrat e kandidatëve të cilët Paneli i dërgon në Kuvendin e Kosovës dhe Qeveri (për t'u përzgjedhur) do të publikohen në faqen zyrtare të Bankës Qendrore. Me aplikimin për pozitën e Guvernatorit/es, konsiderohet se kandidati/ja ka dhënë pëlqimin për publikimet në fjalë.

Afati i fundit për aplikim është **21 qershor 2023**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e Panelit do të ftohen për intervistë.